

# 1. Multimedia

## Pyetja 1

Cila nga alternativat më poshtë tregon përparësinë e ruajtjes së informacionit në formatin dixhital kundrejt formatit analog?

- A) Mund të gjenden dhe korrigjohen gabimet
- B) Nuk ka asnjë përparësi
- C) Informacioni dixhital kërkon më pak hapësirë për tu ruajtur
- D) Informationi dixhital ka shpejtësi më të lartë transmetimi

## Pyetja 2

Në cilën nga mënyrat e mëposhtme të komunikimit infomacioni rrjedh në të dy drejtimet njëkohësisht:

- A) Simplekse (simplex)
- B) Gjysëm Duplekse (half-duplex)
- C) Duplekse e plotë (full-duplex)
- D) Multicast

## Pyetja 3

Një pajisje STB (Set Top Box) e lidhur me një televizor mundëson komunikimin midis:

- A) një përdoruesi dhe një televizori
- B) një televizori dhe një serveri
- C) një përdoruesi dhe një serveri
- D) dy përdoruesve të lidhur në internet

## Pyetja 4

Në lidhje me informacionin dixhital cili nga pohimet më poshtë është i vërtetë:

- A) Eficenca e algoritmeve të kompresimit varët nga natyra e të dhënave
- B) Mbi tekstet nuk mund të aplikohet kompresim
- C) Mbi imazhet nuk mund të aplikohet kompresim
- D) Mbi videot nuk mund të aplikohet kompresim

## Pyetja 5

Njësia matëse bazë e shpejtësisë së transmetimit të të dhënave dixhitale është:

- A) dps
- B) bps
- C) dpm
- D) dpi

## Pyetja 6

Funksioni i një modemi është :

- A) Të konvertojë sinjalin analog në dixhital dhe anasjelltas
- B) Të konvertojë vetëm sinjalin analog në dixhital
- C) Të konvertojë vetëm sinjalin dixhital në analog
- D) Të rrugëzojë paketat me protokollin IP

Pyetja 7

Funksioni i një protokollit komunikimi është :

- A) Të përcaktojë formatin e mesazheve që do të shkëmbehen, rradhën e tyre dhe veprimet që duhen ndërmarrë kur merret një mesazh
- B) Të përcaktojë formatin e mesazheve që do të shkëmbehen
- C) Të përcaktojë mënyrën e kompresimit të paketave që do të shkëmbehen
- D) Të filtrojë paketat e dëmshme në rrjetin e komunikimit

Pyetja 8

Akronim i POTS është:

- A) Post Office and Telephone System
- B) Public Old Telephone Station
- C) Private Office Telephone Service
- D) Plain Old Telephone Service

Pyetja 9

Akronimi i ISDN është:

- A) International Service Data Network
- B) Integrated Service Digital Network
- C) International System for Data Networks
- D) International Service Digital Network

Pyetja 10

Në një linjë ISDN cirkuiti i aksesit quhet:

- A) Fiber Optic Line (FOL)
- B) Digital Subscriber Line (DSL)
- C) Ethernet Based Network Line (EBNL)
- D) Basic Rate Access (BRA)

Pyetja 11

Një aplikacion që i mundëson disa personave që të flasin njëkohësisht me njëri-tjetrin nëpërmjet aparateve telefonike dhe kompjuterave quhet:

- A) CTI- Computer Telephony Integration
- B) Postë Zanore
- C) Telekonferencë
- D) Videokonferencë

Pyetja 12

Një URL - Uniform Resource Locator, përfaqëson:

- A) Një tag html për përfshirjen e imazheve
- B) Adresën e një faqeje web
- C) Një tag html për përfshirjen e një klipi audio në faqe
- D) Adresën e një kompjuteri në rrjetin lokal

Pyetja 13

Nëse një kompjuter po shpërndan paketa në rrjet me destinacion të gjithë kompjuterat e rrjetit kjo mënyre transmetimi quhet:

- A) Multicast
- B) Multicast Group
- C) Broadcast
- D) Limited Multicast

Pyetja 14

Karta e zërit në një kompjuter përpara se ta dërgojë sinjalin e tingullit në bokse e konverton atë në:

- A) sinjal audio analog
- B) sinjal audio dixhital të pakompresuar
- C) sinjal audio dixhital të kompresuar
- D) karta audio nuk bën konvertim të sinjalit audio që del nga kompjuteri

Pyetja 15

Protokolli i transportit më i përshtatshëm për transmetimin nëpërmjet internetit e të dhënave multimediale në kohë reale (live) është:

- A) TCP
- B) UDP
- C) RTP
- D) HTTP

Pyetja 16

Në rastin e transmetimit multimedial në web nëpërmjet nje streaming serveri të dedikuar serveri i web i dërgon browserit një skedar përshkrues duke përdorur protokollin:

- A) HTTP
- B) UDP
- C) RTP
- D) RTSP

Pyetja 17

Në lidhje me imazhet dixhitale cili nga pohimet e mëposhtme është i vërtetë:

- A) Imazhet matricore ruhen si një matricë pikash llogjike.
- B) Imazhet matricore ruhen si një përshkrim gjeometrik i imazhit
- C) Imazhet matricore zënë më shumë memorie se sa imazhet vektoriale.
- D) Imazhet matricore e ruajnë cilësinë edhe kur afishohen në dimensione të ndryshme nga dimensionimi origjinal

Pyetja 18

Veprimet që kryen një program për afishimin e një imazhi në ekranin e kompjuterit janë:

- 1- Programi bën render imazhin
- 2- Programi lexon skedarin ku është ruajtur imazhi
- 3- Programi ndërton modelin e brendshëm të imazhit

Zgjidhni rradhën e saktë të këtyre veprimeve.

- A) 1-2-3
- B) 3-2-1
- C) 2-1-3
- D) 2-3-1

Pyetja 19

Cili nga proceset e mëposhtme njihet me emrin RENDER:

- A) Ndërtimi i modelit të brendshëm të imazhit
- B) Gjenerimi i matricës së pikave duke u nisur nga modeli i brendshëm i imazhit
- C) Kompresimi i një imazhi me shumë ngjyra
- D) Montimi i disa klipëve video në një klip të vetëm

Pyetja 20

Cila është njësia bazë e matjes së rezolucionit të imazheve?

- A) dpi- dots per inch
- B) dpp- dots per pixel
- C) ppp - pixel per dot
- D) bps - bits per second

Pyetja 21

Në lidhje me skedarët e imazheve cili nga pohimet mëposhtë nuk është i vërtetë:

- A) Formatimi GIF përdor kompresimin me humbje
- B) Formatimi JPEG përdor kompresimin me humbje
- C) Imazhet në formatin TIFF janë më të përshtatshme për t'u përdorur në web
- D) Teknikat e kompresimit të skedarëve grafikë ndahen në teknika kompresimi me humbje dhe në teknika kompresimi pa humbje

## 2. Hardware dhe Rrjeta Kompjuterike

### Pyetja 1

Cila nga pajisjet e mëposhtme nuk është pajisje hyrëse

- A) Mousi
- B) Tastiera
- C) Printeri
- D) Ekрани me prekje

### Pyetja 2

Çfarë është RAM në një kompjuter?

- A) Random Access Memory
- B) Right Administration Module
- C) Regulatory for Automatic Motherboards
- D) Right Access Module

### Pyetja 3

Cila nga pajisjet e mëposhtme nuk është pajisje dalëse

- A) Scanner
- B) Printer
- C) Ekran i thjeshte
- D) Bokset e muzikës

### Pyetja 4

Cila nga memorjet e mëposhtme nuk është memorje e qëndrueshme

- A) Memorja e jashtme me USB
- B) Harddisqet IDE
- C) RAM
- D) Hardisqet SCSI

### Pyetja 5

Termi RAID përdoret në kompjutera për

- A) Një lloj pastruesi për ekranin
- B) Redundant Array of Interconnected Disks
- C) Remote Administration Internet Device
- D) Right Administration for Inter site Distribution

### Pyetja 6

Serveri ka dy disqe të instaluar për t'u mbrojtur nga humbja e të dhënave në rast se dëmtohet një disk. Nga një luhatje e tensionit njëri nga disqet është djegur megjithatë serveri nuk e ka ndërprerë punën dhe nuk kanë humbur të dhëna. Çfarë konfigurimi mund të ketë serveri?

- A) RAID 0
- B) RAID 1

- C) RAID 5
- D) RAID 10

Pyetja 7

Konfigurimi RAID 1 ka nevojë për të paktën:

- A) 2 disqe
- B) 3 disqe
- C) 4 disqe
- D) 10 disqe

Pyetja 8

Konfigurimi RAID 5 ka nevojë për të paktën:

- A) 2 disqe
- B) 3 disqe
- C) 4 disqe
- D) 10 disqe

Pyetja 9

Një server në të cilin janë instaluar 4 disqe me nga 72GB të lidhur me një RAID controller i cili është konfiguruar me skemën RAID 1, sa është hapësira disponibël në këtë server?

- A) 288 GB
- B) 216 GB
- C) 144 GB
- D) 72 GB

Pyetja 10

Një server në të cilin janë instaluar 4 disqe me nga 72GB të lidhur me një RAID controller i cili është konfiguruar me skemën RAID 5, sa është hapësira disponibël në këtë server?

- A) 288 GB
- B) 216 GB
- C) 144 GB
- D) 72 GB

Pyetja 11

Çfarë është VPN në rrjetat kompjuterikë:

- A) Voltage Ports Networks
- B) Virtual Private Network
- C) Virtual Port Naming
- D) Voltage Ports Name

Pyetja 12

Cili nga pohimet e mëposhtme përshkruan VPN

- A) Lidhjet VPN mund të krijohen vetëm midis kompjuterave me sistem operimi Linux ose Unix
- B) Lidhjet VPN janë mënyra më e mirë e enkriptimit sepse ato përdorin certifikatat që njihen vetëm nga institucioni që përdor këtë lidhje VPN.
- C) VPN shërben për autentikimin e nyjeve fundore të rrjetit dhe enkripton paketat e të dhënave
- D) VPN nuk përdoren më në ditët e sotme pasi korporatat kanë ndërtuar rrjetat e tyre private

Pyetja 13

Cila është arsyeja që protokollu TCP është më i ngadaltë se protokollu UDP?

- A) TCP ka mbingarkesë sepse dërgon paketa që shërbejnë për ruajtjen e sekuencës dhe korigjimit të gabimeve
- B) TCP është një protokoll më i vjetër se UDP
- C) UDP mund të përdoret për të transmetuar të dhëna në fibrat optike ndërsa TCP jo.
- D) UDP nuk pret për konfirmimin e mbërritjes së paketës në destinacion, ndërsa TCP ridërgon të njëjtën paketë derisa të marrë konfirmimin që ajo mbërriti në destinacion

Pyetja 14

Çfarë është një zonë e demilitarizuar, DMZ, në LAN?

- A) Një segment i rrjetit ku duhen vendosur të gjithë serverat të cilët mund të aksesohen pa u autentikuar
- B) Një segment i rrjetit ku vendoset serveri i postës elektronike
- C) Një segment i rrjetit ku duhen vendosur serverat që duhet të kapen nga jashtë rrjetit të cilët nuk kanë nevojë për një nivel shumë të lartë sigurie
- D) Segmenti i rrjetit me nivelin më të lartë të sigurisë

Pyetja 15

Cili është funksioni i një firewall-i?

- A) Mban një tabelë që lidh adresat e dy rrjeteve në mënyrë që paketat të kalohen nga njëri rrjet në tjetrin
- B) Ekzaminon paketat dhe vendos cila prej tyre mund të kalojë në rrjetin tjetër.
- C) Kontrollon paketat e të dhënave për viruse për të ndaluar paketat e infektuara
- D) Nuk lejon kalimin e viruseve nga njëri rrjet në tjetrin

Pyetja 16

Çfarë është NIC në terminologjinë e rrjetave?

- A) Network Interface Card
- B) Network Interface Container
- C) Network Interpreter Card
- D) Network Interpolation Chiller

Pyetja 17

Çfarë janë "paketat", "segmentet" dhe "frame" në terminologjinë e rrjetave?

- A) Pjesët e ruterave Cisco
- B) Komponentë thelbësore to faqeve web
- C) Terma të përdorur për të përshkruar blloqet e informacionit ndërsa ato kalojnë nëpër stivën e protokolleve të modelit OSI.
- D) Protokolle të përdorura në shtresa të veçanta të modelit OSI.

Pyetja 18

Çfarë është Gigabit Ethernet?

- A) Rrjeta që janë konform standartit IEEE 802.3u
- B) Rrjeta të ndërtuara me fibër optike ose me kablo që kanë një shpejtësi maksimale transmetimi 1Gbps.
- C) Rrjeta të ndërtuara me valë radio që kanë një shpejtësi maksimale transmetimi 1Gbps.
- D) Rrjeta të ndërtuara me pajisje të aprovuara nga WIFI Alliance

Pyetja 19

Çfarë është e vërtetë për VoIP?

- A) VoIP mund të tolerojë humbje të mëdha të paketave pa e reflektuar këtë në cilësinë e bisedës
- B) Nëse ka një humbje të vogël paketash biseda telefonike mund të vazhdojë pa u ndërprerë, ndonse do të ketë shprehje të fjalëve.
- C) Nëse gjatë një telefonate VoIP një paketë humbet, telefonata ndërpritet në çast
- D) Nëse gjatë një telefonate VoIP humbet një paketë, telefonata ndërpritet dhe aparati i marrësit bën automatikisht një thirrje të re telefonike.

Pyetja 20

Çfarë është një socket?

- A) Kombinimi i një adrese IP dhe një numri porte
- B) Kështu quhet ndryshe një numër porte
- C) Kombinimi i një adrese fizike (MAC address) dhe një numri porte
- D) Një protokoll transporti

Pyetja 21

Në cilin nivel të modelit OSI funksionojnë HUB-et?

- A) Niveli i transportit
- B) Niveli Fizik
- C) Niveli i rrjetit
- D) Niveli i prezantimit

Pyetja 22

Cili është numri i portës që përdoret zakonisht për serverat HTTP?

- A) 160



- B) 80
- C) 8
- D) 25

Pyetja 23

Cili është numri i portës që përdoret zakonisht për serverat FTP?

- A) 24
- B) 21
- C) 81
- D) 25

### 3. Microsoft, Access, Powerpoint dhe Sistem Shfrytëzimi

Pyetja 1

PowerPoint përshkruhet më mirë si:

- A) Softueri për prezantim
- B) Softuer baze të dhënash
- C) Softuer për editim teksti
- D) Softuer për vizatim

Pyetja 2

Tregoni cilat nga deklarat nuk është e vërtetë:

Microsoft Powerpoint është një koleksion:

- A) Skicash
- B) Shënimesh
- C) Paraqitje(slides)
- D) Formulash matematike

Pyetja 3

Nëse do të shtonit disa faqe nga prezantime të tjera në prezantimin korrent çfarë komande do të zgjidhnit:

- A) Nga Menuja Insert zgjidhni New Slide
- B) Nga Menuja Insert zgjidhni Slide Number
- C) Nga Menuja Insert zgjidhni Slides From File
- D) Nga Menuja Insert zgjidhni Slides From OutLine

Pyetja 4

Në një prezantim PowerPoint :

- A) Të dyja llojet e mediave (zëri dhe filmi) nuk mund të përfshihen.
- B) Të dyja llojet e mediave (zëri dhe filmi) mund të përfshihen.
- C) Mund të përfshihet zëri por jo filmi.
- D) Mund të përfshihet filmi por jo zëri.

Pyetja 5

Kur fshini një objekt të tipit fushë teksti nga një faqe paraqitjeje në PowerPoint :

- A) Fshihen si fusha e tekstit ashtu edhe teksti.
- B) Fusha e tekstit dhe teksti brenda mbetet.
- C) Fusha e tekstit fshihet, por teksti mbetet.
- D) Mbetet fusha e tekstit bosh.

Pyetja 6

Një grafik mund të futet si pjesë e prezantimit duke zgjedhur:

- A) Nga menuja Insert>Pictures
- B) Nga menuja Insert> Chart
- C) Nga menuja Insert>Diagrame
- D) Nga menuja Insert>Table

Pyetja 7

Cili tipar i PowerPointit shton efekte speciale për modifikimin e paraqitjes si dhe kohën për çdo faqe?

- A) Skemat e ngjyrave
- B) Animacioni
- C) Konfigurimi i kalimeve
- D) Dizajnimi i faqeve

Pyetja 8

Tregoni se cilat nga deklaratat e mëposhtme rreth sistemit të shfrytëzimit nuk është e vërtetë:

Një sistem shfrytëzimi:

- A) është një ndërfaqje ndërmjet përdoruesit dhe kompjuterit.
- B) është programi i parë që ngarkohet kur hapet kompjuteri.
- C) alokon burimet e sistemit në mënyrë eficiente.
- D) menaxhon vetëm pjesët softuerike të sistemit.

Pyetja 9

Sistemet \_\_\_\_\_ përdoren në ambiente ku besueshmëria dhe koha janë faktorë kritikë dhe të dhënat duhen procesuar brenda një limiti të ngushtë kohe.

- A) me kohë reale
- B) batch
- C) hibridë
- D) interaktiv

Pyetja 10

Sistemi i operimit MS-DOS është shkurtimi i:

- A) Microsoft Digital Operating System
- B) Microsoft Desktop Operating System
- C) Microsoft Disk Operating System
- D) Microsoft Devices Operating System

Pyetja 11

Cila nga të mëposhtmet nuk është një sistem shfrytëzimi?

- A) Microsoft Windows
- B) MAC OS
- C) Solaris
- D) Microsoft Access

Pyetja 12

Cila nga të mëposhtmet nuk është një funksion i sistemi të shfrytëzimit?

- A) Menaxhimi i Proçeseve
- B) Menaxhimi i memorjes
- C) Menaxhimi i Pajisjeve
- D) Menaxhimi i orës së sistemit

Pyetja 13

Një proçes është :

- A) Sistemi i operimit
- B) Trajtues gabimesh
- C) Një program në ekzekutim
- D) Aplikacion që menaxhon skedarët

Pyetja 14

Sistemet batch lehtësojnë performacën e sistemit pasi:

- A) programi ekzekutohet në mënyrë të padukshme për përdoruesin
- B) reduktojnë kohën njerëzore të përgatitjes së të dhënave për ekzekutim.
- C) shfrytëzohet proçesimi paralel.
- D) shfrytëzohet më mirë koha e CPU-së

Pyetja 15

Në problemin e lexim-shkrimit, proçeset a dhe b lejohen të aksesojnë njëkohësisht të njëjtin burim vetëm nëse :

- A) a dhe b janë duke lexuar
- B) a dhe b janë duke shkruar
- C) Ose a ose b është duke lexuar
- D) Ose a ose b është duke shkruar

Pyetja 16

Një pajisje driveri është:

- A) Thirrje sistemi
- B) Një rutinë softuerike që shërben për të ndërfaqësuar një pajisje harduerike
- C) Një komponente periferike harduerike
- D) Tipar i pajisjes që lejon lidhjen me sistemin e operimit.

Pyetja 17

Cila nga të mëposhtmet nuk është funksion i sistemeve të operimit?

- A) Menaxhimi i memorjes
- B) Menaxhimi i aplikacioneve
- C) Mbrojtja ndaj viruseve
- D) Menaxhimi i diskut

## 4. Gjuha C/C++

Pyetja 1

Tregoni se cila nga alternativat e mëposhtme mund të shërbejë si emër variabli:

- A) kend\_gjerë
- B) float
- C) #shuma
- D) 10shuma

Pyetja 2

Tregoni sa do të jetë vlera e variablit shuma pas ekzekutimit të segment kodit:

```
int a=3; int b=4;  
int shuma;  
a=a+b;  
shuma=a+b;
```

- A) 8
- B) 9
- C) 10
- D) 11

Pyetja 3

Jepet ekuacioni algebrik:  $y = a * x^2 + 5$ . Cili nga instruksionet e mëposhtëm është paraqitja e saktë në C?

- A)  $y = a * x + 2 * 5$
- B)  $y = a * x * x + x$
- C)  $y = a * x * x + 5$
- D)  $y = a + x * (x + 5)$

Pyetja 4

Të tregohet se çfarë do të afishojë në ekran segment kodi i mëposhtëm:

```
int a,b;
a=5; b=10;
if(a==b)
    a=b;
else if(a>b)
    a=a+a;
else
    b=25;
printf("%d %d", a,b);
```

- A) 5 25
- B) 5 10
- C) 10 25
- D) 10 10

Pyetja 5

Tregoni se çfarë afishon segment kodi i mëposhtëm:

```
int i=1;
while(i<=10)
{printf("%d ",i);
  i++;}
printf("%d %d", a,b);
```

- A) 0 1 2 3 4 5 6 7 8 9
- B) 1 2 3 4 5 6 7 8 9 10
- C) 2 3 4 5 6 7 8 9 10 11
- D) 1 1 1 1 1 1 1 1 1 1

Pyetja 6

Tregoni se çfarë afishon segment kodi i mëposhtëm:

```
int i=0;
while(++i<=10)
{ if (i%2==0) continue;
  printf("%d ", i);

}
```

- A) 1 2 3 4 5
- B) 1 3 5 7 9
- C) 0 1 2 3 4
- D) 2 4 5 6 8

Pyetja 7

Tregoni se cili segment program gjen më të voglin x që plotëson kushtin  $3^x < 1500$ .

A) `int produkt=1; int x=0;`  
`while(produkt<=1500)`  
`{ x++;`  
`produkt=produkt*3; }`

B) `int produkt=1; int x=1;`  
`while(produkt<=1500)`  
`{ x++;`  
`produkt=produkt*3; }`

C) `int produkt=3; int x=0;`  
`while(produkt<=1500)`  
`{ x++;`  
`produkt=produkt*3; }`

D) `int produkt=1; int x=3;`  
`while(produkt<=1500)`  
`{ x++;`  
`produkt=produkt*3; }`

Pyetja 8

Cila nga të mëposhtmet nuk është një tip të dhënash në C?

- A) short
- B) int
- C) long
- D) boolean

Pyetja 9

Cili tip të dhënash kërkon më shume byte?

- A) short
- B) int
- C) long
- D) unsigned int

Pyetja 10

Në mënyrë që të paraqitet një kostante numerike heksadecimale në një program C, përdorni

- \_\_\_\_\_.
- A) 16#
  - B) x0
  - C) 0
  - D) 0x

Pyetja 11

Shprehja:  $3 - 2/5$  do të kishtë si vlerë \_\_\_\_\_.

- A) 0.2
- B) 2.6

- C) 1
- D) 3

Pyetja 12

Cili nga operatorët e mëposhtëm është operator binar?

- A) ~
- B) !
- C) /
- D) &

Pyetja 13

Cili nga deklaratimet e mëposhtëm nuk është valid?

- A) x int;
- B) char c;
- C) float f, y=-1.0;
- D) long int AjA;

Pyetja 14

Gjeni sa do të ishte vlera e variablit a pas ekzekutimit të instruksioneve të mëposhtme.

```
int a = 2;  
int x = 11;  
int y = -1;  
a*=y;
```

- A) -1
- B) -2
- C) 2
- D) 0

Pyetja 15

Çfarë do të afishohet nëse kompilohet dhe ekzekutohet kodi C i mëposhtëm:

```
#include<stdio.h>  
int main()  
{int array[3]={10};  
int i;  
for(i=0;i<=2;i++)  
printf("%d ",array[i]);  
return 0; }
```

- A) 10 garbage garbage
- B) 10 10 10
- C) 10 null null
- D) 10 0 0

Pyetja 16

Çfarë do të afishohet nëse kompilohet dhe ekzekutohet kodi C i mëposhtëm:

```
#include<stdio.h>
int main()
{ int a=5;
  int b=10;
  { int a=2;
    a++;
    b++;  }
  printf("%d %d ", a,b);
  return 0; }
```

A) 5 10

B) 6 11

C) 5 11

D) 6 10

Pyetja 17

Çfarë do të afishohet nëse kompilohet dhe ekzekutohet kodi C i mëposhtëm:

```
#include<stdio.h>
int main()
{ int array[2][2][3]={{0,1,2},{3,4,5}},{6,7,8},{9,10,11}};
  printf("%d", array[1][0][2]);
  return 0; }
```

A) 5

B) 6

C) 7

D) 8

Pyetja 18

Çfarë do të afishohet nëse kompilohet dhe ekzekutohet kodi C i mëposhtëm:

```
#include<stdio.h>
void call(int,int,int);
int main()
{int a=10;
  call(a,a+1,++a);
  return 0; }
void call(int x, int y, int z)
{ printf("%d %d %d", x,y,z);}
```

A) 11 12 11

B) 10 11 11

C) 10 11 10

D) 10 11 12



Pyetja 19

Nëse harrohet instruksioni `#include <stdio.h>` në programin C:

- A) përcaktimet standarte për rutinat e hyrje daljeve nuk do të përfshihen.
- B) nuk shkakton problem pasi kompilatori di se ku të shikojë.
- C) do të ngarkohet automatikisht nëse nevojiten rutinat e hyrje daljeve.
- D) nuk shkakton problem pasi lidhësi di se ku të shikojë.

Pyetja 20

Cili nga të mëposhtmit nuk është një emër variabli i vlefshëm në C:

- A) alpha
- B) float
- C) shuma
- D) \$shuma

Pyetja 21

Sa byte rezervohen për një variabël të tipit `unsigned char`?

- A) 4
- B) 2
- C) 1
- D) 8

Pyetja 22

Për të përdorur funksionet matematikore në program duhet përfshirë:

- A) `<stdio.h>`
- B) `<math.lib>`
- C) `<math.h>`
- D) `<stdio.lib>`

Pyetja 23

Shprehja e kontrollit që përdoret në instruksionin `switch` për të testuar raset nuk mund të jetë i tipit :

- A) `int`
- B) `long`
- C) `char`
- D) `float`

Pyetja 24

Në instruksionin `printf("%d", &x)`:

- A) printohet vlera e numrit të plotë në adresën `x`
- B) printohet vlera e shënjesit të quajtur `x`
- C) printohet vlera e adresës të `x`-it
- D) printohet vlera e numrit `double` në adresën `x`

Pyetja 25

Çfarë do të afishohet nëse ekzekutohet programi i mëposhtëm:

```
#include<stdio.h>
int main()
{ float a=0.5,b=0.9;
  if(a && b>0.9)
    printf("Java");
  else
    printf("C++");
  return 0; }
```

A) Java

B) C++

C) Null

D) Java C++

Pyetja 26

Çfarë do të afishohet nëse ekzekutohet programi i mëposhtëm:

```
#include<stdio.h>
int main()
{ int x=5,y=10;
  if(!(!x) && x)
    printf("%d",x);
  else
    printf("%d",y);
  return 0; }
```

A) 1

B) 0

C) 5

D) 10

Pyetja 27

Çfarë do të afishohet nëse ekzekutohet programi i mëposhtëm:

```
#include<stdio.h>
int main(){ int a = 320;
char *ptr;
ptr =( char *)&a;
printf("%d ", *ptr);
return 0; }
```

A) 44

B) 66

C) 32

D) 64

Pyetja 28

Çfarë do të afishohet nëse kompilohet dhe ekzekutohet programi i mëposhtëm:

```
#include<stdio.h>
int main(){
char arr[10]="Gjuha e programimit C";
printf("%s",arr);
return 0; }
```

- A) Gjuha e pro
- B) Gjuha e programimit C
- C) Gjuha C
- D) Gabim kompilimi

Pyetja 29

Çfarë do të afishohet nëse ekzekutohet programi i mëposhtëm:

```
#include<stdio.h>
int main(){
int a=5,b=6,c=8;
c=a==b;
printf("%d",c); }
```

- A) 0
- B) 1
- C) 5
- D) 8

Pyetja 30

Çfarë do të afishohet nëse ekzekutohet segmenti i kodit të mëposhtëm:

```
int x = 5;
int y = x++;
printf("%d %d", x, y);
```

- A) 5 6
- B) 6 5
- C) 5 5
- D) 6 6

Pyetja 31

C quhet shpesh:

- A) Gjuhë e orientuar nga objektet
- B) Gjuhë assembluese
- C) Gjuhë e nivelit të lartë
- D) Gjuhë makine

Pyetja 32

Cikli në të cilin instruksionet ekzekutohen të paktën një herë quhet:

- A) do while
- B) while
- C) for
- D) goto

Pyetja 33

Çdo direktivë preproçesuese në C fillon me :

- A) #
- B) include
- C) main()
- D) {

Pyetja 34

Një tabelë me pointera është e njëjtë me:

- A) një pointer tek tabela
- B) pointer tek pointerat
- C) pointer në struktura
- D) pointer në funksione

Pyetja 35

Një variabël që është i aksesueshëm vetëm në funksionin në të cilin përcaktohet quhet:

- A) variabël statik
- B) variabël global
- C) variabël i jashtëm
- D) variabël lokal

Pyetja 36

Çfarë do të afishohet nëse ekzekutohet segment kodi i mëposhtëm:

```
char *p = "abcd";  
printf ("%c", *(p++));
```

- A) a
- B) b
- C) c
- D) d

Pyetja 37

Çfarë do të afishohet nëse ekzekutohet segment kodi i mëposhtëm:

```
int x=15;  
printf("%d %d %d", x>20, x=20, x<30);
```

- A) 15 1
- B) 0 20 1

- C) 15 20 30
- D) 0 0 0

Pyetja 38

Çfarë do të afishohet nëse ekzekutohet segment kodi i mëposhtëm:

```
int a = 5;  
a << 1;  
printf("%d", a);
```

- A) 2
- B) 3
- C) 4
- D) 5

Pyetja 39

Operatorët << dhe >> janë:

- A) operatorë vlerëdhënieje
- B) operatorë relacionale
- C) operatorë zhvendosjeje
- D) operatorë logjik

Pyetja 40

Çfarë do të afishohet nëse ekzekutohet segment kodi i mëposhtëm:

```
int k, num=30;  
k=(num>5 ? (num<= 10 ? 100:200):500);  
printf("\n%d", k);
```

- A) 100
- B) 500
- C) 30
- D) 200

Pyetja 41

int \*\*ptr; është:

- A) Deklarim i pasaktë
- B) Pointer tek pointeri
- C) Pointer tek numri i plotë
- D) Adresa e numrit të plotë

Pyetja 42

Në C, kur kalohet një tabelë si argument i një funksioni, ajo çfarë kalohet është :

- A) Vlera e një elementi në tabelë
- B) Elementi i parë i tabelës
- C) Adresa e tabelës

D) Adresa e elementit të fundit të tabelës

Pyetja 43

Në cilën fazë kodi i mëposhtëm `#include<stdio.h>` do të zëvendësohet nga përmbajtja e skedarit `stdio.h`.

- A) Gjatë editimit
- B) Gjatë lidhjes
- C) Gjatë ekzekutimit
- D) Gjatë preproçesimit

Pyetja 44

Tregoni se çfarë do të afishohet pas ekzekutimit të programit të mëposhtëm `#include<stdio.h>`

```
#define CUBE(x) (x*x*x)
int main()
{ int a, b=2;
  a = CUBE(b++);
  printf("%d, %d\n", a, b);
  return 0; }
```

- A) 27, 5
- B) 9, 4
- C) 27, 3
- D) 8, 3

Pyetja 45

Tregoni se çfarë do të afishohet pas ekzekutimit të programit të mëposhtëm.

```
#include<stdio.h>
#define MAX(a, b) (a > b ? a : b)
int main() {
  int x;
  x = MAX(5*2, 3+5*2);
  printf("%d\n", x);
  return 0; }
```

- A) 10
- B) 11
- C) 12
- D) 13

Pyetja 46

Tregoni se çfarë do të afishohet pas ekzekutimit të programit të mëposhtëm.

```
#include<stdio.h>
#define PRINT(i) printf("%d ",i)
int main()
```

```
{ int x=0, y=2, z=4;
  PRINT(x++);
  PRINT(++y);
  PRINT(z);
  return 0; }
```

- A) 0 2 4
- B) 0 3 4
- C) 1 2 4
- D) 1 3 4

Pyetja 47

Numrat oktalë paraprihen nga:

- A) 0
- B) 0x
- C) #
- D) \_

Pyetja 48

Cili është rendi i duhur për vlerësimin e shprehjes së mëposhtme?

$z = x + y * z / 10 \% 3 - 12$

- A) = \* / % + -
- B) \*/ % + - =
- C) %\* / - + =
- D) / \* % - + =

Pyetja 49

Cila nga versionet e mëposhtme paraqet përdorimin korrekt të operatorit të përzgjedhjes?

- A)  $a > b ? c = 10 : c = 20;$
- B)  $a > b ? c = 24;$
- C)  $\max = a > b ? a > c ? a : c : b > c ? b : c$
- D)  $\text{return } (a > b) ? (a : b)$

Pyetja 50

Cili nga operatorët e mëposhtëm është operator relacional në C?

- A) &&
- B) !
- C) |
- D) ==

Pyetja 51

Si do të rrumbullakosni vlerën nga 2.76 në 3.0?

- A)  $\text{ceil}(2.76)$

- B) floor(2.76)
- C) roundup(2.76)
- D) roundto(2.76)

Pyetja 52

Tregoni se çfarë do të afishohet pas ekzekutimit të programit të mëposhtëm.

```
#include<stdio.h>
int X=10;
int main()
{ int X=15;
  printf("%d\n", X);
  return 0; }
```

- A) 10
- B) 15
- C) 0
- D) 20

Pyetja 53

Cili nga operatorët e mëposhtëm nuk është operator logjik?

- A) %
- B) &&
- C) ||
- D) !

Pyetja 54

Cili nga tipet e mëposhtme nuk mund të përdoret në instruksionin switch case?

- A) char
- B) int
- C) double
- D) enum

Pyetja 55

Tregoni se cili instruksion duhet shtuar pas #include<stdio.h> në mënyrë që programi i mëposhtëm të punojë në mënyrë korrekte.

```
#include<stdio.h>
int main()
{ printf("%f\n", sqrt(36.0));
  return 0; }
```

- A) #include<conio.h>
- B) #include<math.h>
- C) #include<stdlib.h>
- D) #include<dos.h>



Pyetja 56

Supozoni se  $x$  është i tipit float dhe duam ta rrumbullakosim në një numër të plotë. Mënyra më e mirë për ta realizuar këtë është:

- A)  $y = \text{int}(x + 0.5)$
- B)  $y = (\text{int})x + 0.5$
- C)  $y = (\text{int})((\text{int})x + 0.5)$
- D)  $y = (\text{int})(x + 0.5)$

Pyetja 57

Cili nga funksionet e mëposhtme është më i përshtatshëm për të lexuar një string të përbërë nga disa fjalë?

- A) `printf();`
- B) `scanf();`
- C) `gets();`
- D) `getc();`

Pyetja 58

Cila nga funksionet e mëposhtme gjen gjatësinë e një stringu?

A) `int xstrlen(char s)`

```
{ int length=0;
  while(*s!='\0')
    length++; s++;
  return (length); }
```

B) `int xstrlen(char *s)`

```
{ int length=0;
  while(*s!='\0')
    length++;
  return (length); }
```

C) `int xstrlen(char *s)`

```
{ int length=0;
  while(*s!='\0')
    s++;
  return (length); }
```

D) `int xstrlen(char *s)`

```
{ int length=0;
  while(*s!='\0')
    { length++; s++; }
  return (length); }
```

Pyetja 59

Nëse dy stringje janë identike, atëherë funksioni `strcmp()` kthen:

- A) 0
- B) 1

- C) 2
- D) -1

Pyetja 60

Një tregues (pointer) është:

- A) Fjalë kyçe që përdoret për të krijuar variabla.
- B) Një variabël që përdoret për të ruajtur adresën e një instruksioni.
- C) Një variabël që përdoret për të ruajtur adresën e një variabli tjetër.
- D) Fjalë kyçe që përdoret për të huazuar memorje.

Pyetja 61

Cili skedar duhet të përfshihet në mënyrë që të përdoren funksionet si malloc() dhe calloc()?

- A) memory.h
- B) string.h
- C) dos.h
- D) stdlib.h

Pyetja 62

Supozoni se kemi huazuar memorje me anë të instruksioneve.

```
int **p;
```

```
p=(int **) malloc(2*sizeof(int *));
```

Cili është instruksioni që çliron memorjen e huazuar?

- A) memfree(int p);
- B) dealloc(p);
- C) malloc(p, 0);
- D) free(p);

Pyetja 63

Tregoni se çfarë do të afishohet pas ekzekutimit të programit të mëposhtëm.

```
#include<stdio.h>
```

```
int main()
```

```
{   const char *s = "";
```

```
    char str[] = "C++";
```

```
    s = str;
```

```
    while(*s)
```

```
        printf("%c", *s++);
```

```
    return 0; }
```

- A) ""
- B) C
- C) C+
- D) C++

Pyetja 64

Tregoni se çfarë do të afishohet pas ekzekutimit të programit të mëposhtëm.

```
#include<stdio.h>
int get();
int main()
{ const int x = get();
  printf("%d", x);
  return 0; }
int get()
{ return 25%3 + 3; }
```

- A) 3
- B) 4
- C) 5
- D) 25

Pyetja 65

Tregoni se çfarë do të afishohet pas kompilimit dhe ekzekutimit të programit të mëposhtëm.

```
#include<stdio.h>
int main() {
  const int i=0;
  printf("%d\n", i++);
  return 0; }
```

- A) 0
- B) 1
- C) Gabim kompilimi
- D) Gabim ekzekutimi

Pyetja 66

Variablat a dhe b janë deklaruar dhe inicializuar si më poshtë:

```
float a=3.00;
double b=5.25;
```

Tregoni se cili nga funksionet e mëposhtme printf duhet të përdoret për të afishuar a dhe b sipas tipeve të tyre.

- A) printf("%Lf %f", a, b);
- B) printf("%Lf %Lf", a, b);
- C) printf("%f %Lf", a, b);
- D) printf("%f %lf", a, b);

Pyetja 67

Për të ruajtur sipas tipeve të variablave a dhe b të deklaruara si më poshtë, tregoni cili nga funksionet scanf() duhet të përdoret.

```
float a; double b;
```

- A) scanf("%f %f", &a, &b);
- B) scanf("%f %lf", &a, &b);

- C) scanf("%Lf %Lf", &a, &b);
- D) scanf("%lf%lf", &&a, &&b);

Pyetja 68

Operatori që është më i përshtatshëm për të përcaktuar nëse një bit i caktuar është 0 apo 1 është:

- A) &
- B) &&
- C) ||
- D) !

Pyetja 69

Tregoni se çfarë do të afishohet pas ekzekutimit të programit të mëposhtëm.

```
#include<stdio.h>
```

```
int main() {  
    int s=0;  
    while(s++<10) {  
        if(s<4 )  
            continue;  
        printf("%d ", s); } }
```

- A) 4 5 6 7 8 9
- B) 1 2 3 4 10
- C) 4 5 6 7 8 9 10
- D) 3 4 5 6 7 8 9

*Pyetja 70 te hiqet*

Është dhënë funksioni dhe programi i mëposhtëm.

```
int f(char &c, int *i)
```

```
{c=c + (char)*i;
```

```
*i++; }
```

```
int main() {
```

```
char ch='x';
```

```
int i=10; }
```

Si mund të thërrisni funksionin f me parametrat ch dhe i?

- A) f(&c,\*i);
- B) f(c,i);
- C) f(&ch, &i);
- D) f(ch,&i);

Pyetja 71

Cili operator përdoret për të aksesuar anëtarin e klasës nëpërmjet një objekti (ose instance)?

- A) .
- B) <<

- C) ::
- D) >>

#### Pyetja 72

Teknologjia e orientuar nga objektet përdor \_\_\_\_\_ për të ndihmuar ripërdorimin e kodit dhe arkitekturës, ndërsa tipari i \_\_\_\_\_ i siguron sistemit stabilitet, pasi një ndryshim i vogël në kërkesa nuk kërkon ndryshime të mëdha në sistem.

- A) Enkapsulimi, trashëgimia
- B) Trashegimia, polimorfizmi
- C) Trashegimia, enkapsulimi
- D) Polimorfizmi, abstraksion

#### Pyetja 73

Çfarë atributesh kanë të gjitha objektet softuerike?

- A) Objektet softuerike përbëhen nga komponente kompjuterike.
- B) Objektet softuerike kanë identitet, gjendje dhe sjellje.
- C) Objektet softuerike kanë RAM, ROM dhe procesorë.
- D) Objektet softuerike kanë variabla.

#### Pyetja 74

Është dhënë deklarimi i klasës:

```
class Shembull
{ private: int i;
  public: Shembull (int n)
    { i = n; } };
```

Si do të deklaroni një objekt Shembull që inicializon variablin i me vlerën 10. Supozoni se x është emri i objektit.

- A) Shembull s ; s. Shembull (10 )
- B) Shembull s(10 ) ;
- C) Shembulls(i=10);
- D) Shembull s; s.i=10;

#### Pyetja 75

Cila nga deklaratat e mëposhtme është e gabuar në C++?

- A) Emri i destruktoret duhet të fillojë me ~.
- B) Destruktori thërritet automatikisht kur objekti shkatërrohet
- C) Konstruktori inicializon objektin kur krijohet
- D) Njësoj si funksionet e tjerë konstruktori ka një listë me parametra dhe një tip kthimi.

#### Pyetja 76

Një konstruktor thërritet sa herë që :

- A) Një objekt krijohet

- B) Një objekt përdoret
- C) Një klasë deklarohet
- D) Një klasë përdoret

Pyetja 77

Një destruktore merr:

- A) Zero argument
- B) Një argument
- C) Dy argumente
- D) Shumë argumente

Pyetja 78

Sa objekte të një klase të caktuar mund të ndërtohen në një program?

- A) Një objekt për një variabël të deklaruar.
- B) Aq objekte sa kërkohen nga programi.
- C) Vetëm një objekt ndërtohet për çdo ekzekutim të programit
- D) Vetëm një objekt për një klasë.

Pyetja 79

Konsideroni funksionin e mëposhtëm:

```
void test(int &x, int y)
{ x++;
  y++;
  y = y/x; }
```

Duke supozuar se variablat a dhe b kanë vlera:

int a=3,b=4;

cilat janë vlerat e a dhe b pasi thërritet funksioni test(a,b)?

- A) a=3 b=4
- B) a=4 b=4
- C) a=3 b=1
- D) a=4 b=1

Pyetja 80

Shumica e anëtarëve variabël në C++ klasifikohen si:

- A) Të mbrojtur
- B) Të fshehur
- C) Privatë
- D) Publikë

Pyetja 81

Çfarë bën kodi strcpy(a\_array, "mesazhi")?

- A) Kopjon "mesazhi" në a\_array.

- B) Shton "mesazhi" në fund të a\_array.
- C) Shton "mesazhi" në fillim të a\_array.
- D) Krahason a\_array me "mesazhi"

Pyetja 82

Cili nga të mëposhtmet akseson një variabël info në strukturën \*s?

- A) s.info;
- B) s-info;
- C) s>info;
- D) s->info

Pyetja 83

Cili është indeksi i elementit të fundit të një tabele me 20 elementë?

- A) 0
- B) 19
- C) 20
- D) 21

Pyetja 84

Me çfarë karakteresh përfundon një string i përbërë nga një tabelë karakteresh?

- A) \b
- B) \e
- C) \s
- D) \0

Pyetja 85

Cili nga instruksionet e mëposhtme ngarkon në mënyrë korrekte memorjen?

- A) char a=new char[20];
- B) char \*a=new char[20];
- C) char a=new char(20.0);
- D) char \*a=new char[20.0];

Pyetja 86

Çfarë vlerë kthen funksioni strcmp("Java","C++")?

- A) 1
- B) -1
- C) 0
- D) 7

Pyetja 87

Tregoni se çfarë afishon segment kodi i mëposhtëm:

```
int x=3, y=1;
int *p=&x;
(*p)--;
p=&y;
y++;
printf("%d", *p);
```

- A) 0
- B) 1
- C) 2
- D) 3

#### Pyetja 88

Supozoni se kemi ndërtuar një klasë Shembull. Klasa ka një konstruktor "default". Për klasën e përshkruar më sipër, tregoni se cilat nga instruksionet e mëposhtme deklaron një shënjes(pointer) në një objekt të tipit Shembull, të quajtur s.

- A) Shembull \*s;
- B) Shembull &s= new Shembull;
- C) Shembull s\*;
- D) Shembull \*s = new Shembull;

#### Pyetja 89

Cili nga instruksionet e mëposhtme gjen pozicionin e parë të 'a' në një string të quajtur mesazh. Mund të supozoni se stringu ka të paktën një a.

- A) mesazh.indexOf('a');
- B) mesazh.index('a');
- C) mesazh.find('a');
- D) mesazh.charAt('a');

#### Pyetja 90

Çfarë vlere kthen funksioni test kur thërritet me vlerën 5?

```
int test ( int numer )
{   if ( numer <= 1 )
    return 1;
    else
    return numer * test( numer - 1 ); }
```

- A) 0
- B) 5
- C) 25
- D) 120

#### Pyetja 91

Cili nga instruksionet e mëposhtme është një përdorim ilegal i funksionit put?

- A) cout.put( 'C' );



- B) `cout.put( "C" );`
- C) `cout.put( 'C' ).put( '\n' );`
- D) `cout.put( 67 );`

Pyetja 92

Vlerësoni shprehjen  $(00001000) \&\& (11000101) \wedge (11110000)$

- A) 00001101
- B) 11000000
- C) 00111101
- D) 11110000

Pyetja 93

Në mënyrë që të bëhen veprimet me skedarët në C++, cilët nga header files duhet të përfshihen?

- A) `<iostream>` dhe `<fstream>`
- B) `<cstdio>` dhe `<fstream>`
- C) `<cstdio>` dhe `<iostream>`
- D) `<cstdio>` dhe `<fstream>`

Pyetja 94

Një konstruktor mund të specifikojë tipin e kthimit:

- A) Numër i plotë i tipit `int`.
- B) Një string.
- C) Nuk kthen asgjë ose `void`
- D) Nuk mund të specifikojë tip kthimi.

Pyetja 95

Tregoni sa elemente ka një tabelë e deklaruar si `int a[ 3 ][ 5 ]`?

- A) 3
- B) 5
- C) 15
- D) 8

Pyetja 96

Tabela kalohet \_\_\_\_\_, ndërsa elementët individual kalohen \_\_\_\_\_.

- A) si vlerë, si referencë.
- B) si referencë, si vlerë.
- C) si vlerë, si vlerë.
- D) si referencë, si referencë.

Pyetja 97

Kur një argument kalohet si vlerë, ndryshimet në funksionin e thirrur \_\_\_\_\_ në vlerën origjinale të variablit; kur një argument kalohet si referencë ndryshimet në funksionin e thirrur \_\_\_\_\_ në vlerën origjinale të vlerës së variablit.

- A) ndikojnë, ndikojnë
- B) nuk ndikojnë, ndikojnë
- C) ndikojnë, nuk ndikojnë
- D) nuk ndikojnë, nuk ndikojnë

Pyetja 98

Konsideroni instruksionet e mëposhtme:

```
char *ptr;  
ptr = "hello";  
cout << *ptr;  
Çfarë do të printohet?
```

- A) Shkronja e parë
- B) Gjithë stringu
- C) Shkronja e fundit
- D) Gabim sintakse

Pyetja 99

Funksioni i operatorit new është :

- A) të kthejë një shënjesë(pointer) në një variabël.
- B) të krijojë një variabël të quajtur new.
- C) të marrë memorje për një variabël të ri.
- D) të tregojë sa memorje është e gatshme.

Pyetja 100

Proçesi i ndërtimit të klasave të reja nga klasat ekzistuese quhet \_\_\_\_\_.

- A) Polimorfizëm
- B) Strukturë
- C) Trashëgimi
- D) Mbishkrim

Pyetja 101

Anëtarët e klasave që janë statike:

- A) Nuk mund tu caktohet një vlerë.
- B) Mund të përdoren vetëm në funksione statike.
- C) Nuk mund të përdoren me Union.
- D) Nuk mund të aksesohen brenda klasës.

Pyetja 102

Supozoni se funksioni increment implementohet si më poshtë:

```
void increment(int x)
```

```
{x++;}
```

Tregoni se sa është vlera e variabli a pas veprimeve të mëposhtme:

```
int a= 10;
```

```
increment(a+1);
```

A) 9

B) 10

C) 11

D) 12

Pyetja 103

Tregoni se çfarë afishohet pas ekzekutimit të segment kodit të mëposhtëm:

```
int stats[2][3]={2,3,4,5,6,7};
```

```
int totalHits=0;
```

```
for(int row=0; row<2; row++)
```

```
    totalHits+=stats[row][0];
```

```
    printf("%d", totalHits);
```

A) 5

B) 6

C) 7

D) 11

Pyetja 104

Tregoni se çfarë do të afishohet pas ekzekutimit të programit të mëposhtëm:

```
#include<stdio.h>
```

```
int main()
```

```
{ int a=3;
```

```
  int b=4;
```

```
  { int a=0;
```

```
    a++;
```

```
    b++; }
```

```
